


D. G. Parlamenti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROJEKTLIGJ

NR ____/2019

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10242, DATË 25.2.2010 “PËR INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të neneve 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,
me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, shkronja a), bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Shkronja a) ndryshohet me këtë përmbajtje:

“a). “Periudha e komunizmit” është periudha e historisë së Shqipërisë nga 29 nëntori 1944 deri më 8 dhjetor 1990.”

Neni 2

Në nenin 18, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Nëpunësit dhe punonjësit e institutit e të arkivit duhet të jenë persona që gëzojnë besueshmëri. Për qëllimet e këtij ligji, i besueshëm është çdo person, i cili ka mbushur moshën madhore përpara datës 8 dhjetor 1990, është pajisur me Certifikatë të Sigurimit të Personelit nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe nuk ka qenë:

a) anëtar ose kandidat i PKS-së a PPSH-së;

b) i shkolluar ose nuk ka bërë kualifikime në shkollat e larta politike të sigurimit ose

mbrojtjes të Shqipërisë a të vendeve të Traktatit të Varshavës;
c) funksionar i sistemit komunist, pjesëtar i organeve të diktaturës komuniste apo bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit;
ç) anëtar ose bashkëpunëtor i shërbimeve inteligjente të vendeve të Traktatit të Varshavës.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
GRAMOZ RUÇI